

# A JETOJMË MË MIRË?

## EFEKTET E NDIHMËS FINANCIARE PËR VERIUN E KOSOVËS PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT

Jovana Jakovljević, Sanja Sovrlić, Marija Milenković







**Botues**

InTER

**Për botuesin**

Dragiša Mijačić

**Autorë**

Jovana Jakovljević

Sanja Sovrlić

Marija Milenković

**Recenzioni**

Vesela Ćurković

Dragiša Mijačić

**Përkrahja teknike**

Jasna Žarković

**Dizejني**

Tatjana Potežica

**Viti**

2016

Studimi është bërë në kuadër të projektit "Efektet e investimeve në veri të Kosovës pas marrëveshjeve të Brukselit – A jetojmë më mirë?", finansuar nga KFOS. Përmbajtja e studimit ekskluzivisht është përgjegjësi e autorit dhe në asnjë rast nuk paraqet qëndrimet e KFOS.

**A JETOJMË MË MIRË?**

**EFEKTET E NDIHMËS FINANCIARE PËR VERIUN  
E KOSOVËS PAS MARRËVESHJES SË BRUKSELIT**

**Jovana Jakovljević, Sanja Sovrlić, Marija Milenković**









**HYRJE**

**1**



Marrëveshja për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, në opinion e njohur edhe si Marrëveshja e Brukselit, është nënshkruar më 19 prill 2013. Një prej rezultateve direkte të kësaj marrëveshjeje është mbajtja e zgjedhjeve lokale në tërë territorin e Kosovës, përfshirë edhe komunat në veri të Kosovës, të cilat i ka mbështetur edhe Qeveria e Republikës së Serbisë, pas së cilës u themeluan qeveritë lokale sipas ligjeve të Kosovës. Në këtë mënyrë, janë krijuar kushtet për ndihmë financiare qeverive lokale në veri të Kosovës, si nga Qeveria e Kosovës ashtu edhe nga Bashkimi Evropian.

Gjatë vitit 2014 Qeveria e Kosovës ka filluar ndarjen e mjeteve në mbështetje të zhvillimit dhe integritit të katër komunave të veriut, ndërsa mjete të konsiderueshme për zhvillimin e komunave të veriut janë investuar edhe nga Bashkimi Evropian. Krahas kësaj, në bazë të Marrëveshjes mbi doganat, të nënshkruar nga Beogradi dhe Prishtina, është themeluar edhe Fondi për zhvillimin e veriut të Kosovës, ku derdhen mjetet nga doganami i mallrave të ndërmarrjeve të katër komunave nga veriu i Kosovës, si dhe i mallit të destinuar për shpenzim në këto komuna.

Lëndë e kësaj analize do të jenë investimet në katër komunat e veriut të Kosovës (Mitrovica e veriut, Zveçani, Zubin Potoku dhe Leposaviqi) nga tre burimet e financimit: Fondi për zhvillimin e veriut të Kosovës, Bashkimi Evropian dhe Qeveria e Kosovës.

Në fillim të vitit 2016, Instituti për zhvillimin ekonomik territorial (InTER) dhe RTV Mir nga Leposaviqi kanë iniciuar hulumtimin "Efektet e investimeve në veri të Kosovës pas Marrëveshjes së Brukselit - A jetojmë më mirë?" kjo me synim t'i kontribuohet njohjes së procesit të aplikimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe përmirësimit të informimit të qytetarëve lidhur me dobitë që rrjedhin nga kjo marrëveshje. Hulumtimi është financuar në kuadër të konceptit "Reconnecting Mitrovica" të cilin e financon Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur. Është me rëndësi të theksohet se të gjeturat dhe mendimet e parashtruara në këtë studim nuk paraqesin qëndrimet e Fondacionit Kosovar për Shoqëri të Hapur.

Në kuadër të hulumtimit, janë kryer tre studime analitike lidhur me përmasat dhe efektin e investimeve në katër komunat e veriut të Kosovës, prej të cilëve i pari ka të bëjë me investimet e Qeverisë së Kosovës në projektet kapitale, i dyti për mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian këtyre komunave dhe e treta për projektet e mbështetura në kuadër të Fondit për zhvillim të veriut të Kosovës (fondit doganor). Në fund jepen konkluzione me rekomandime.

Në fund të kësaj pjese hyrëse, është me rëndësi të theksohet se ekipi hulumtues është takuar me një varg sfi-dash në realizimin e këtij studimi, para se gjithash me qasjen në informata me rëndësi publike, si në nivelin lokal, ashtu edhe në atë qendror.



**BASHKËFINANCIMI NGA QEVERIA E  
KOSOVËS NË REALIZIMIN E PROJEK-  
TEVE INFRASTRUKTURE NË VERI  
TË KOSOVËS NË VITIN 2015.**

**2**



## 2.1 HYRJE

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë në prill të vitit 2013, në nëntor të të njëjti vit janë mbajtur zgjedhje lokale dhe janë themeluar kuvendet komunale sipas ligjeve të Kosovës. Me këtë, janë krijuar kushte që këto qeveri lokale t'i shfrytëzojnë mjetet e Qeverisë së Kosovës, si për funksionimin e tyre ashtu edhe për investime kapitale.

Pas konsultimit me përfaqësues të qeverive lokale nga veriu i Kosovës, Qeveria e Kosovës, gjatë vitit 2014, mori vendim me të cilën parashiheshin mjete të veçanta për financimin e projekteve kapitale infrastrukturore në këto komuna në vitin 2015. Këto mjete në buxhet janë emërtuar si "Bashkëfinancimi i kuvendeve komunale të Mitrovicës së veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit", me çka theksohet ekskluziviteti i komunave në veri të Kosovës për shfrytëzim të kësaj linje buxhetore. Në këtë mënyrë iu është dhënë mbështetje përfaqësuesve të zgjedhur të pushtetit lokal për integrimin e këtyre komunave në sistemin juridik të Kosovës

Në kuadër të kësaj linje buxhetore janë ndarë 15.170.000 euro, të shpërndara në tetë ministritë përkatëse: Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria për Komunitete dhe Kthim dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Fondet janë ndarë në mes komunave sipas kriterëve që kanë të bëjnë me strukturën socio-demografike të komunave, para se gjithash me numrin e popullsisë, por edhe me karakteristika tjera (numri i shkollave, numri i fëmijëve, numri i personave në nevojë, numri i klubeve të regjistruara sportive, etj.). Përfaqësuesit e komunave kanë pasur vërejtje për metodologjinë e shpërndarjes së fondeve, kryesisht për vlerësimin e numrit të popullsisë, që ka çuar në negociata shtesë dhe krijimin e vonësive në përdorimin e fondeve nga kjo linjë buxhetore.

Para fillimit të realizimit të fondeve të projekteve kapitale infrastrukturore, ministritë përkatëse kanë nënshkruar një Marrëveshje bashkëpunimi me kryetarët e katër komunave në veri të Kosovës.<sup>1</sup> Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje janë krijuar kushtet për ndarjen e mjeteve në Departamentin e Thesarit të Ministrisë së Financave të Kosovës, për të cilën gjë janë informuar qeveritë lokale. Vetëm pas marrjes së konfirmimit për sigurimin e fondeve nga Thesari, qeveritë lokale kanë qenë në gjendje të inicojnë procedurat e tenderimit për realizimin e punëve.

Vlen të përmendet se paratë për realizimin e projekteve nuk janë paguar në llogaritë e qeverive lokale, por ministritë përkatëse, përmes Departamentit të Thesarit në Ministrinë e Financave, zbatimin e projektit ia kanë paguar direkt kontraktorit në bazë të situatave të paraqitura të ndërtimit, të cilat i kanë nënshkruar bashkërisht organet e inspektimit të ministrive përkatëse dhe autoriteteve lokale.<sup>2</sup>

## 2.2 PËRMASAT E REALIZIMIT TË FONDEVE PËR PROJEKTET KAPITALE INFRASTRUKTURE

Në kuadër të linjës buxhetore të cekur, qeveritë lokale nga veriu i Kosovës kanë propozuar 148 projekte kapitale për financim, në vlerë prej 16.303.810 euro, ashtu që për disa projekte komunat kanë propozuar bashkë-financim edhe nga burimet e veta.

<sup>1</sup> Ligji nr. 05/L-001, Buxheti i Kosovës për vitin 2015

<sup>2</sup> Situatat e ndërtimit (e përkohshme dhe përfundimtare), trajtohen si llogaritë dhe paraqesin dokumentin për furnizime, respektivisht vlerat e punëve të kryera


**Tabela 1:** Numri i projekteve të propozuara dhe shuma financimit të kërkuar nga ministrinë përkatëse

Ministrinë e Qeverisë së Kosovës	Numri i projekteve të propozuara	Shuma totale (në euro)
Ministria e infrastrukturës	20	3.651.000
Ministria e Shëndetësisë	6	999.995
Ministria e kulturës, rinisë dhe sporteve	8	1.270.000
Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	21	2.000.000
Ministria e punës dhe mirëqenies sociale	7	1.250.000
Ministria e ambientit dhe planifikimit hapësinor	17	1.898.000
Ministria për komunitete dhe kthim	30	4.251.000
Ministria e administrimit të pushtetit lokal	39	983.815
<b>GJITHSEJ</b>		<b>16.303.810</b>

Bazuar në kriteret për ndarjen e fondeve për qeveritë lokale, të drejtën për investime më të mëdha ka pasur komuna e Leposaviqit (49 projekte, 4.858.955 euro), pasuar nga Mitrovica e Veriut, e cila ka propozuar një numër më të vogël të projekteve, por vlerat e tyre kanë qenë më të larta (23 projekte, 4.099.800 euro), e ndjekur nga Zveçani (37 projekte, 3.997.445 euro) dhe në fund Zubin Potoku (37 projekte, 3.097.610 euro).

Në mesin e projekteve të propozuara, më të përfaqësuar kanë qenë ata që kishin të bëjnë me zhvillimin e infrastrukturës. Në këtë fushë, komuna e Leposaviqit ka propozuar 43 projekte në shumë totale 4.633.175 euro, Mitrovica e Veriut 19 projekte me një shumë totale 3.219.800 euro, Zubin Potoku ka propozuar 35 projekte infrastrukturore për shumën 3.007.610 euro dhe Zveçani 28 projekte në vlerë prej 3.513.175 euro. Pjesa tjetër e projekteve kanë të bëjnë me blerjen e pajisjeve, si më poshtë: 6 projekte në Leposaviq me shumë totale 225.780 euro, në Mitrovicë të Veriut 4 projekte me një shumë totale 880.000 euro, në Zubin Potok 90.000 euro për 2 projekte dhe në Zveçan 284.270 euro për 7 projekte.

Kur është fjala për projekte që kanë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sipërmarrësisë, këtu mund të veçohen vetëm dy projekte, përkatësisht projekti "Ndërtimi i qendrës së blerjes për blerjen e produkteve bujqësore dhe pyjore" në Leposaviq, me një vlerë të përgjithshme prej 250,000 euro dhe projekti "Zhvillimi i sipërmarrësisë dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme" në Zveçan, për të cilin janë alokuar 100.000 euro.

**Grafiku 1:** Kategoritë më të përfaqësuara të projekteve sipas komunave



Shikuar sipas sektorëve, investimet që kanë të bëjnë me trafikun, përkatësisht infrastrukturën rrugore, janë më të përfaqësuar në të gjitha komunat përveç Mitrovicës Veriore: Zveçani me 6 projekte me një vlerë të përgjithshme prej 830.000 euro, Zubin Potoku me 13 projekte me një vlerë të përgjithshme prej 1.289.050 euro dhe Leposaviqi me 13 projekte me një vlerë totale prej 1.818.805 euro. Në anën tjetër, në Mitrovicën e Veriut është numri më i madh i projekteve të planifikuara për ndërtesa banimi, në total 6 projekte, që kapin vlerën prej 889.900 euro.

Megjithatë, numri i projekteve për një sektor të caktuar nuk pasqyron plotësisht edhe mjetet financiare për të njëjtin. Derisa në komunat e Zubin Potokut dhe Leposaviqit sektori i transportit është dominant edhe sipas numrit të projekteve edhe sipas shumës së mjeteve financiare, në dy komunat tjera në veri të Kosovës është një situatë e ndryshme. Shikuar në këtë mënyrë, në Mitrovicën e Veriut investimet më të mëdha janë të planifikuara për arsimin, 1.100.000 euro për 3 projekte, kurse në komunën e Zveçanit për mbrojtjen sociale 1.150.000 euro për 4 projekte.

**Tabela 2:** Lartësia e investimeve të planifikuara financiare sipas sektorëve dhe komunave (në euro)

Sektorët	Leposaviq	Mitrovica e Veriut	Zubin Potok	Zveçan
Trafiku	1.818.805	340.000	1.289.050	830,000
Ndriçimi publik	195.195	190.000	350.000	100,000
Qeverisja lokale	170.000	100.000	19.760	69,360
Shëndetësia	199.995	600.000	110.000	129,580
Arsimi	504.980	1.130.000	159.890	250,000
Kultura dhe tradita	60.000	9.900	10.000	44,890
Ujësjellësi dhe kanalizimi	53.980	120.000	19.300	159,870
Mbrojtja sociale	250.000	420.000	640.000	1,250,000
Mbrojtja e mjedisit	77.195	50.000	80.000	89,220
Ndërtesat e banimit	98.000	889.900		9,525
Mbeturinat komunale	122.805	125.000	170.000	
Rinia, sporti dhe rekreacioni	991.000		249.610	430,000
Rregullimi i varrezave	67.000			465,000
Zhvillimi i sipërmarrësisë, dhe NVM-ve				100,000
Mbrojtja nga zjarri				70,000
Mbështetje për përpunimin e mishit, perimeve...	250.000			

Projektet e financuara nga ministritë e caktuara, shikuar sipas sektorëve, në disa raste nuk kanë qenë në përputhje me fushëveprimin e punës së ministrisë. Kështu, nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është planifikuar 4.8% e projekteve për ujë dhe kanalizim, nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 14.3% e projekteve për mbrojtjen e mjedisit, nga Ministria për Komunitete dhe Kthim 16.7% e projekteve për rregullimin e varrezave.

Si një shembull pozitiv i përputhshmërisë së projektit me departamentin e ministrisë së caktuar mund të merret projekti "Ndërtimi i 20 shtëpive për personat e zhvendosur brenda vendit nga kategoritë sociale", i cili është dorëzuar në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, kurse propozimi i projektit ka ardhur nga komuna e Zveçanit.


**Tabela 3:** Sektorët më të përfaqësuar sipas ministrive

Ministritë e Qeverisë së Kosovës	Sektori	Përqindja sipas sektorëve (%)
Ministria e infrastrukturës	Trafiku	80
Ministria e shëndetësisë	Shëndetësia	100
Ministria e kulturës, rinisë dhe sportit	Rinia, sporti dhe rekreacioni	62,5
Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Arsimi	95,2
Ministria e punës dhe mirëqenies sociale	Mbrojtja sociale	71,4
Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor	Mbrojtja e mjedisit dhe mbeturinat komunale	41
Ministria për komunitete dhe kthim	Mbrojtja sociale	16,7
Ministria e administrimit të pushtetit lokal	Qeverisja lokale	10,3

### 2.3 PËRQINDJA E REALIZIMIT TË PROJEKTEVE TË PLANIFIKUARA DHE FONDET E SHPENJUARA

Nga një total prej 148 projekteve, sa janë planifikuar nga qeveritë lokale në veri të Kosovës, janë realizuar 76 projekte, 31 janë në proces të implementimit, dy janë anuluar, një nuk është realizuar, ndërsa 27 projekte as nuk kanë filluar me implementimin.<sup>3</sup>

Vetëm komuna e Zubin Potokut ka qenë në gjendje të realizojë të gjitha projektet, ndërsa realizimi në komunat tjera është më i ulët se 50%. Komuna e Zveçanit ka realizuar 48.6% të projekteve, në proces të realizimit janë 29.7%, kurse 2.7% as nuk janë filluar. Pjesa e mbetur prej 2.7% as nuk janë miratuar.<sup>4</sup> Komuna e Mitrovicës së Veriut ka realizuar 47.8% të projekteve të planifikuara, në proces të realizimit janë 43.5%, ndërsa 2 projekte janë anuluar në ministritë përkatëse dhe nuk kanë hyrë në procesin e implementimit. Përqindja më e ulët e realizimit është në komunën e Leposaviqit, e cila ka realizuar gjithsej 21.7% të projekteve, në proces të realizimit janë 20.4%, nuk janë filluar 56,5%, ndërsa për 6.1% nuk është i njohur statusi i projektit.

**Grafiku 2:** Përqindja e realizimit të projekteve sipas komunave

<sup>3</sup> 11 projektet e mbetura janë ato të cilëve iu është ndryshuar destinimi, nuk janë nënshkruar Memorandumet ose ka të dhëna që mungojnë, dhe këto janë kryesisht nga komuna e Leposaviqit

<sup>4</sup> Ajo që trajtohet "jo të miratuar" janë projektet që janë iniciuar nga qeveria lokale në një ministri të caktuar por është ndryshuar destinimi për një projekt tjetër, nuk është nënshkruar Memorandumi me ministrinë ose ka pasur pengesa për realizim (p.sh.. blerja e pajisjeve të zjar- rifikësve, projekti fillimisht është kërkuar nga MAPL, por komunës së Zveçanit iu është dhënë përgjigje se këtë pajisje mund të blejë vetëm MPB e Kosovës, dhe kjo e ka kufizuar këtë qeveri lokale që të bëjë ri-destinimin e fondeve brenda afatit të caktuar)

Kur është fjala për mjetet e realizuara, të cilat kanë të bëjnë me projektet e përfunduara dhe ato që janë në proces të realizimit, në komunën e Zubin Potokut janë shpenzuar në total 3.058.388 euro, në komunën e Zveçanit 2.165.963 euro, në Mitrovicën Veriore 1.984.188 euro, ndërsa në komunën e Leposaviqit janë shpenzuar në total vetëm 2.967.976 euro. Një pjesë e konsiderueshme e mjeteve të shpenzuara në komunën e Leposaviqit ka të bëjë me ndërtimin e pishinës olimpike, për të cilën janë shpenzuar 849.891 euro (vlera totale e planifikuar e këtij projekti është 850.000 euro). Mirëpo, ky projekt ka qenë temë e debatit në asamblenë komunale të qeverisë lokale, për shkak se nuk ishte e njohur se si janë paguar situatat e përkohshme të ndërtimit sepse shuma e mjeteve të shpenzuara nuk pasqyron gjendjen aktuale të punëve në terren.

Shkaqet që kanë çuar në vonesa në realizimin e projekteve janë problemet me nënshkrimin e Memorandumit, dhe më vonë edhe miratimi i fondeve për shfrytëzim, respektivisht dhënia e Certifikatës për fondet e rezervuara nga Departamenti i Thesarit të Ministrisë së Financave. Për këto arsye, paratë për projektet e caktuara kanë qenë në dispozicion vetëm në fillim të Shtatorit të vitit 2015, kurse procesi i tenderimit ka mundur të fillojë vetëm pas kësaj. Në vend që dokumentacioni dhe procedura e përzgjedhjes së kontraktorit të kryhet në pranverë, për shkak të vonesave në ndarjen dhe rezervimin e fondeve, procedurat janë filluar vetëm në muajt e vjeshtës. Prandaj, fillimi i punimeve është shtyer që nga fillimi, dhe më pas vonesave iu kanë kontribuar moti i keq dhe temperaturat e ulëta.

Edhe pse afati i fundit për realizimin e projekteve ishte Dhjetori i vitit 2015, tre nga katër qeveritë lokale nuk kanë përfunduar projektet e filluara, as edhe deri në Korrik të vitit 2016. Nëse me rishikimin e buxhetit fondet nuk miratohen për shfrytëzim, ekziston një rrezik real që projektet mos të përfundojnë as në vitin 2016. Në këtë rast, qeveritë lokale do të duhet të kërkojnë fonde shtesë nga buxheti i Qeverisë së Kosovës apo burimet tjera të financimit, për të përfunduar projektet që janë tashmë në proces. Duke pasur parasysh faktin se në komunën e Leposaviqit është përqindja më e ulët e realizimit të projekteve të planifikuara, dhe se janë edhe 26 projekte zbatimi i të cilëve as nuk ka filluar, gjasat janë më të mëdha që komuna mos të arrijë të realizojë të gjitha projektet e filluara.

## 2.4 KONKLUZION

Edhe pse Qeveria e Kosovës në vitin 2015 ka ndarë fonde të konsiderueshme për projekte kapitale të qeverive lokale në veri të Kosovës, përshtypja e përgjithshme është se komunat kanë qenë shumë ambicioze gjatë propozimit të numrit dhe madhësisë së projekteve që do të realizoheshin në territoret e tyre përkatëse, veçanërisht kur kihet parasysh se shumica e komunave nuk kishin kapacitete të mjaftueshme teknike dhe administrative për të përgatitur dhe realizuar projekte të këtyre përmasave. Vetëm komuna e Zubin Potokut ka arritur të realizojë të gjitha mjetet e kërkuara, ndërkohë që përqindja e realizimit në komunat tjera është nën 50%. Nga kjo mund të nxirret konkluzioni se do të ishte më praktike që realizimi i fondeve të alokuara të ishte ndarë në dy ose tre cikle buxhetore, e jo në një.

Kufizimi në shpenzimin e fondeve të disponueshme po ashtu ka ndikuar në llojin e projekteve të propozuara. Në fakt, shumica e projekteve të propozuara kishin të bëjnë me asfaltimin e rrugëve lokale, rregullimin e rrugëve, por edhe rehabilitimin e ndërtesave të banimit, ndërtimin e rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, dhe të ngjashme. Një numër shumë i vogël i këtyre projekteve mund të konsiderohet si "investim kapital", kryesisht janë në pyetje riparimet, sanimet dhe përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese. Për projekte të tilla nuk ka pasur nevojë për dokumentacion teknik të komplikuar apo për lëshim të lejeve të ndërtimit, që është një çështje veçanërisht e ndjeshme për strukturat politike në veri të Kosovës.

Projektet e realizuara gjithsesi kanë kontribuar në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve të katër komunave në veri të Kosovës, janë asfaltuar një numër i madh i rrugëve në vendbanime dhe rrugëve rurale, fonde të konsiderueshme janë investuar për ndërtimin ose rinovimin e ndërtesave dhe objekteve publike, blerjen e pajisjeve, ndriçimin publik, mbrojtjen sociale, përmirësimin e infrastrukturës sportive, strehimin. Megjithatë, në fushën e zhvillimit ekonomik nuk mund të priten efekte të mëdha, para se gjithash për shkak të faktit se një numër i papërfillshëm i projekteve kishte të bënte drejtpërdrejt me këtë fushë (1.3% ose 2 nga 148 projekte).

Në fund, është e nevojshme të përmendim edhe konkluzionin e rëndësishëm që qytetarët nuk kanë marrë pjesë në përzgjedhjen e projekteve të propozuara, dhe gjithashtu nuk është i njohur edhe roli i kuvendeve komunale në këtë proces. Përveç kësaj, procesi i realizimit të projekteve nuk ka qenë transparent, si nga përfaqësuesit e qeverive lokale ashtu edhe nga ministritë e Qeverisë së Kosovës. Asnjëra palë nuk është prononcuar publikisht për këto projekte, as edhe pas realizimit të suksesshëm të investimeve. Prandaj, qytetarët janë privuar nga informacioni në lidhje me të gjitha ato që janë bërë në territorin e tyre, nga cilat fonde dhe në çfarë kushtesh.



MBËSHTETJA FINANCIARE  
E BASHKIMIT EVROPIAN NË  
VERI TË KOSOVËS

3



### 3.1 HYRJE

Kosova që nga viti 1999 deri më sot ka marrë më shumë se 2 miliardë euro ndihmë nga Bashkimi Evropian (BE).<sup>5</sup> Në fillim fondet janë përqendruar në masat e ndihmës humanitare dhe rindërtim, ndërsa fokusi gjatë viteve ka ndryshuar në favor të nxitjes së zhvillimit të institucioneve të Kosovës, zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe sigurimin e të ardhmes Evropiane të Kosovës.

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, vetëm në vitin 2010 BE-ja ka filluar të financojë projektet e para në veri të Kosovës. Që nga atëherë mbështetja financiare është ofruar në kuadër të 7 programeve të ndryshme, në kuadër të të cilave janë ndarë mbi 54,5 milionë euro për 124 projekte që janë realizuar në territorin e katër komunave veriore (Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan).


Për shkak të faktit që përfituesit nga veriu i Kosovës nuk kanë pasur mundësi të aplikojnë për fonde që kanë qenë në dispozicion në pjesët tjera të Kosovës, në shkurt të vitit 2013 BE-ja ka lansuar thirrjen e parë të destinuar vetëm për përfituesit e këtyre komunave, të quajtur Skema e Granteve të BE-së për Veriun I, në kuadër të së cilës janë realizuar 14 projekte. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit dhe mbajtjes së zgjedhjeve lokale, janë krijuar kushte për publikimin edhe të skemës së dytë të granteve për veriuin e Kosovës, Skema e Granteve të BE-së për Veriun II, ku një pjesë e veçantë ka qenë e destinuar për zhvillimin e infrastrukturës komunale. Kjo ka qenë hera e parë që qeveritë lokale nga veriu i Kosovës kanë mundur të aplikojnë për shfrytëzimin e fondeve të BE-së.<sup>6</sup> Kjo thirrje u bë në kuadër të paketës së BE-së për ndihmë shtesë në shumën prej 38,5 milionë euro për katër komunitat në veri të Kosovës. Përveç kësaj, përfituesit nga veriu i Kosovës po ashtu kanë fituar mundësinë që të marrin pjesë në thirrjet që kanë qenë të vlefshme për të gjithë territorin e Kosovës.

Në vijim është dhënë një pasqyrë e mbështetjes financiare të BE-së në kuadër të dy skemave të granteve që kanë qenë të vlefshme vetëm për përfituesit nga veriu i Kosovës. Kjo pasqyrë ka të bëjë me shkallën e mbështetjes, implementimin e projekteve, si dhe me rezultatet e arritura që reflektohen në jetën e qytetarëve në këto komuna.


### 3.2 SHTRIRJA E NDIHMËS FINANCIARE TË BE-SË NËPËRMJET DY SKEMAVE TË GRANTEVE PËR VERIUN E KOSOVËS

Në kuadër të dy skemave të granteve për veriuin e Kosovës, Skema e Granteve të BE-së për Veriun I (GS I) dhe Skema e Granteve të BE-së për Veriun II (GS II), gjithsej janë ndarë 9.503.637 euro për financimin e 79 projekteve që janë realizuar nga komunat, subjektet ekonomike dhe organizatat joqeveritare nga territoret e komunave Leposaviq, Mitrovicë Veriore, Zubin Potok dhe Zveçan.

**Grafiku 3:** Numri i projekteve sipas programit



**Grafiku 4:** Numri i projekteve sipas përfituesve në skemat e granteve I dhe II




<sup>5</sup> Faqja e internetit e Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë: <http://bit.ly/2cRDjgc>

<sup>6</sup> Përjashtim është komuna e Zubin Potokut, e cila në bashkëpunim me organizatat joqeveritare ka realizuar dy projekte në kuadër të skemës së granteve EURED I dhe EURED III.


BE-ja përmes këtyre programeve ka mbështetur zhvillimin e infrastrukturës komunale, zhvillimin ekonomik, zhvillimin bujqësor dhe zhvillimin e sektorit joqeveritar. Në këtë kuadër, në territorin e komunës së Leposaviqit ka financuar 29 projekte, në komunën e Mitrovicës së Veriut 19, në komunën e Zveçanit 16, në komunën e Zubin Potokut 12. Përveç kësaj, janë financuar dy projekte që janë realizuar nga organizatat joqeveritare ndërkombëtare në komunat në veri të Kosovës. Po ashtu, është financuar një projekt i zhvillimit të kooperativave bujqësore, të cilin e kanë realizuar bashkërisht komuna e Zveçanit, komuna e Leposaviqit dhe organizata joqeveritare - Qendra për zhvillimin e komuniteteve lokale. Vlera e këtyre projekteve është 741.468 euro.

**Grafiku 5:** Numri dhe vlera e projekteve nëpër komuna



Në komunën e Leposaviqit përmes 29 projekteve janë investuar 2.795.290 euro. Pothuajse gjysma e kësaj shume, në fakt 1.330.916 euro, është përqendruar në zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet financimit të 24 projekteve. Për zhvillimin e infrastrukturës komunale përmes 3 projekteve janë ndarë 1.368.763 euro, kurse për inkurajimin e zhvillimit ekonomik në këtë komunë janë ndarë gjithsej 95.610 euro. Deri më tani, asnjë nga organizatat jo-qeveritare nga Leposaviqi nuk janë përfituese të ndihmës financiare nga dy thirrjet e bëra nga BE-ja që janë objekt i kësaj analize.


**Grafiku 6:** Fondet e planifikuara në komunën e Leposaviqit, sipas sektorëve



BE-ja ka mbështetur me 3.046.249 euro përfituesit nga komuna e Mitrovicës së Veriut, ku janë financuar 19 projekte. Për 3 projektet për zhvillimin e infrastrukturës komunale janë ndarë 1.233.205 euro. Numri më i madh i projekteve në komunën e Mitrovicës Veriore është fokusuar në zhvillimin ekonomik dhe zhvillimin e sektorit të OJQ-ve, dhe atë 9 projekte në fushën e zhvillimit ekonomik, për të cilët janë ndarë 1.087.977 euro, dhe 5 projekte për mbështetje të organizatave joqeveritare, për të cilat janë ndarë 435.509 euro. Në fushën e zhvillimit të bujqësisë, mbështetje financiare kanë marrë 2 projekte në vlerë prej 289.557 euro.




**Grafiku 7:** Fondet e planifikuara në Komunën e Mitrovicës Veriore, sipas sektorëve




Në komunën e Zveçanit janë financuar 16 projekte me një vlerë të përgjithshme prej 1.852.521 euro. Për zhvillimin e bujqësisë përmes 8 projekteve janë ndarë 292.579 euro. Shumë më tepër mjete janë investuar për të mbështetur zhvillimin ekonomik, 705.416 euro. Kjo shumë është shpërndarë në 6 projekte të ndryshme. Kontributi për zhvillimin e infrastrukturës komunale është arritur me mbështetjen e 2 projekteve në vlerë prej 854.525 euro. Ndihma financiare e BE-së për këtë komunë nuk ka përfshirë projektet për zhvillimin e sektorit të OJQ-ve.

**Grafiku 8:** Fondet e planifikuara në komunën e Zveçanit, sipas sektorëve



Më së paku projekte dhe fonde janë miratuar për komunën e Zubin Potokut. Për gjithsej 12 projekte janë ndarë 1.068.108 euro, nga të cilat 951.491 euro janë investuar në 10 projekte në fushën e zhvillimit të bujqësisë, ndërsa shumën e mbetur prej 116.616 euro në 2 projekte në fushën e zhvillimit ekonomik. Në këtë komunë BE-ja nuk ka mbështetur projektet nga fusha e infrastrukturës dhe mbështetjen e organizatave jo-qeveritare.


**Grafiku 9:** Fondet e planifikuara në komunën e Zubin Potokut, sipas sektorëve



Vlera e projekteve individuale në të katër komunat në veri të Kosovës sillet ndërmjet 20.000 dhe 484.807 euro. Vlera mesatare e projekteve është më e larta në komunën e Mitrovicës së Veriut dhe arrin në 160.328 euro, ndërsa më e ulëta në komunën e Leposaviqit dhe arrin në 102.922 euro. Koha për të cilën projektet po realizohen sillet nga 12 deri në 24 muaj. Në programe dominojnë projektet me kohëzgjatje prej 12 muaj (30 projekte, ose 38% e numrit total të projekteve), të pasuar nga projektet në kohëzgjatje prej 24 muajsh (23 projekte, 29%). Të gjitha projektet kohëzgjatja e të cilëve është në mes 12-18 muaj (gjithsej 56) deri më tani janë realizuar, ndërsa 26 projektet e mbetura, kohëzgjatja e të cilëve është prej 20-24 muaj, janë në proces të realizimit.

Nga numri i përgjithshëm i projekteve, më shumë se gjysma (44 projekte) kanë për qëllim nxitjen e zhvillimit të bujqësisë, zhvillimi ekonomik është mbështetur nga 21 projekte, mbështetja për zhvillimin e infrastrukturës komunale po realizohet nëpërmjet 8 projekteve, kurse sektori joqeveritar është mbështetur me 6 projekte. Si pasojë, shkallën më të mirë të realizimit e kanë projektet nga fusha e zhvillimit ekonomik me 78.3% dhe projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin e bujqësisë me 77.8%. Projektet e OJQ-ve dhe projektet e infrastrukturës janë në masë të madhe ende në procesin e implementimit.

**Grafiku 10:** Niveli i realizimit të projekteve, sipas sektorëve



### 3.3 EFEKTET E PROGRAMEVE TË FINANCUARA NGA PROGRAMET E BE-SË

Duke pasur parasysh se pjesa më e madhe e programeve të financuara ose kanë përfunduar ose janë në vazhdim e sipër, është herët të maten efektet afatgjate të shkaktuara tek ndryshimet shoqëro-ekonomike. Mirëpo, përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave primare dhe sekondare, janë bërë analiza të caktuara të cilat vënë në pah rezultatet e regjistruara në veri të Kosovës.

Përmes ndihmës financiare të Bashkimit Evropian, komunat kanë iniciuar zgjidhjen e disa projekteve të rëndësishme regjionale, siç janë deponia regjionale për tre komunat veriore, apo rruga regjionale ndërmjet Zubin Potokut dhe Istogut, por edhe projekteve lokale siç janë ndërtimi i stacionit të autobusëve dhe renovimi i shtëpisë së shëndetit në Mitrovicën veriore, rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit në Zveqan, apo kopshtit të fëmijëve në Leshak. Me realizimin e këtyre projekteve, qeveritë lokale, deri në një masë të caktuar, kanë ngritur kapacitetet e tyre interne për punë në projekte të BE-së, edhe pse është e qartë që asnjë komunë nuk ka organizuar shërbimet e tyre në mënyrë sistematike me qëllim të realizimit më efikas të këtyre projekteve.

Rezultate më të dukshme pozitive janë realizuar në nivel të ndërmarrjeve individuale të mbështetura në kuadër të projekteve. Këto ndërmarrje kanë avancuar kapacitetet prodhuese, kanë përvetësuar standarde të ISO-së, cilësinë e paketimit dhe brendimit të produkteve, gjë që ka kontribuar rritjes së numrit të punësuarëve të tyre në harkun prej 30-70% si dhe në rritjen e efikasitetit të prodhimit, madje deri në masën 400%. Për shembull, duke iu falenderuar mjeteve të cilat BE i ka siguruar për blerjen e makinave bujqësore, projekti i kultivimit të pjeprave ka shënuar rezultate shumë të mira. Shpenzimet e prodhimit janë zvogëluar madje për 40%, dhe pritjet që vëllimi i prodhimit të rritet për 23%. Përveç kësaj, në atë lëmi bujqësore është rritur edhe numri i punëtorëve sezonal.

Janë shënuar efekte domethënëse përmes projektit të ndërtimit të stabilimenteve ftohëse në Zubin Potok, e cila u shërben jo vetëm komunat fqinje por edhe pjesët tjera të Kosovës. Me ndihmën e mjeteve të BE-së, në të njëjtin stabiliment ftohës janë ndërtuar edhe panelet stolare, me çka është siguruar pavarësia në furnizimin me energji elektrike gjatë periudhës verore. Me projekt gjithashtu është përvetësuar me sukses standardi HASSAP, gjë që ka bërë që 99% të frutave nga ky stabiliment ftohës të gjejë blerës të skajshëm në tregun e jashtëm. Çdo kamion i eksportuar i produkteve nga ky ftohës kanë mundur fitimin vjetor për 12 punëtorë. Duke pasur parasysh se vitin e kaluar janë eksportuar gjithsej 24 maune fruta, ndërsa me llogaritje të thjeshtë arrihet deri te konstatimi se me këtë është siguruar fitimi për 288 punëtorë. Përveç kësaj, ekzistimin i ftohësit ka nxitur prodhuesit bujqësor që të iniciojnë mbjellje të fidanëve të reja, prandaj viteve të fundit është sipërfaqja e mbjellë me mjedra në Zubin Potok është rritur për katër herë.

Mbështetja e BE-së për subjektet afariste në veri të Kosovës i ka kontribuar regjistrimit të tyre në sistemin ligjor kosovar si dhe hapjes së llogarive bankare tek bankat komerciale të Kosovës. Në këtë mënyrë, subjektet afariste të cilët ishin shfrytëzues të programit, është dashur të njoftohen me procedura ligjore për mbajtjen e librave kontabël, eksportit dhe importit, pagesën e doganës dhe tatimeve, regjistrimin e punëtorëve, etj. Gjithashtu, në mënyrë direkte, mjetet financiare të BE-së kanë ndikuar në regjistrimin e qytetarëve tek institucionet e Kosovës për të nxjerrë dokumentet personale (para se gjithashtu letërnjoftimeve).

Subjektet afariste gjithashtu theksojnë efektet pozitive të projekteve të BE-së për përmirësimin e procedurave për menaxhimin e ndërmarrjeve të tyre. Teknikat e menaxhimit të projekteve dhe raportimit, të cilat janë aplikuar gjatë realizimit të projekteve të BE-së kanë vazhduar së aplikuar gjatë afarizimit të rregullt, gjë që ka sjellur deri te rritja e efikasitetit në punë, arkivimin më të mirë të të dhënave dhe menaxhimin financiar.

Efektet pozitive janë arritur edhe në lëminë e zhvillimit të organizatave të shoqërisë civile. Përmes mbështetjes financiare të BE-së (dhe donatorëve të tjerë, para se gjithashtu KFOS-it dhe USAID-it), në veri të Kosovës është krijuar një mjedis dinamik shoqëror ku marrin pjesë aktive disa dhjetëra organizata joqeveritare përmes inicimit të fushatave mbi përgjegjësinë qytetare dhe debate publike. Disa prej organizatave joqeveritare, gjithashtu janë përfshirë realizimi i projekteve ekonomike të zhvillimit, para se gjithash në lëminë e zhvillimit të bujqësisë dhe sipërmarrësisë, por edhe të sektorëve të tjerë (mbrojtja e mjedisit dhe të ngjashme).

## RRITJA E TURIZMIT NË KOMUNËN E ZUBIN POTOKUT

Në kuadër të skemës EURED III, BE ka mbështetur projektin "Outdoor In - zhvillimi i turizmit në Zubin Potok", të i cili është realizuar bashkërisht nga Instituti për zhvillimin ekonomik territorial (InTER) dhe komunës së Zubin Potokut në periudhën 2013-2015. Edhe pse Zubin Potoku ka kushte fantastike natyrore për zhvillimin e turizmit aktiv sepse në një hapësirë të kufizuar gjendet liqeni i Ujmanit, malet Mokra dhe Rogozna, si dhe lumi Ibër, para këtij projekti nuk ka ekzistuar asnjë iniciativë e organizuar që të shfrytëzohen këto potenciale për qëllime të zhvillimit ekonomik të kësaj komune. Mirëpo, projekti ia ka dalur mbanë që të iniciojë zhvillimin e turizmit aktiv në territorin e Kollashinit të Ibrit\* duke vepruar në disa drejtime: nga hartimi i Strategjisë për zhvillimin e turizmit të komunës së Zubin Potokut për periudhën 2015-2020, themelimi i organizatës për menaxhimin e destinacioneve, e deri te zhvillimi i infrastrukturës turistike (ndërtimi i plazhit të parë publik në liqenin e Ujmanit, rrjetit të shtigjeve malore dhe bicikliste në gjatësi prej 120 km, ndërtimit të shkëmbit artificial për ngjitje sportive dhe sallave të fitnesit në të hapur), me organizimi i ngjarjeve turistike dhe promovimit të Kollashinit të Ibrit si destinacion i popullarizuar për turizëm aktiv.

Pas këtij projekti, zhvillimi i turizmit në Kosovë është mbështetur nga Ambasada Finlandeze në Kosovë përmes dy projekteve të cilat kishin të bënin me zhvillimin e përmbajtjeve atraktive turistike (Via Ferrata, MTB) si dhe mbështetje për integrimin e banorëve rural në ekonominë turistike. Ndihmë në zhvillimin e turizmit në Kollashinin e Ibrit kanë ofruar edhe agjencitë e tjera zhvillimore, siç janë SDC përmes projektit PPSE/Sëisscontact, USAID Empoëer dhe UNDP.

Komuna e Zubin Potokut gjithashtu ka realizuar disa projekte të cilat i kanë kontribuar zhvillimit të turizmit, që nga shkallët imponante deri te maja e Gradinës përmbi Zubin Potok, të cilat janë ndërtuar në kuadër të programit të BE-së "Kosova e bukur" e deri te ndërtimi i shtegut për rafting në lumin Ibër, ndërsa në zhvillim e sipër është ndërtimi i bazenit të mbyllur. Përveç kësaj, komuna e Zubin Potokut planifikon ndërtimin e një shtëpie malore dhe renovimin e rrugëve lokale deri te destinacionet turistike.

Sektori privat gjithashtu ka njohur rëndësinë e zhvillimit të turizmit në Kollashin, prandaj para disa viteve janë hapur disa restorane dhe kampe të reja, kryesisht përgjatë liqenit të Ujmanit.

Me promovim të suksesshëm, për një kohë të shkurtër, Kollashini është bërë një destinacion mjaft i popullarizuar turistik për turizmin aktiv në Ballkanin Perëndimor, për çka flet edhe fakti se ky lokacion është përfshirë në listën e guidave të njohura turistike Lonely Planet dhe Petit Futé.

E gjithë kjo i ka kontribuar rritjes së prurjes së turistëve vendore dhe të jashtme në Kollashin. Në vitin 2016, vlerësohet se këtë destinacion do ta vizitojnë rreth 1,000 turistë dhe rreth 5,000 vizitorë, nga çka ekonomia lokale do të përfitojë 150-200,000 euro.

\* Kollashini i Ibrit është emërtimi tradicional për Zubin Potokun

Efektet domethënëse pozitive janë arritur edhe në ndërlidhjen e akterëve të ndryshëm, para se gjithash në bashkëpunimin ndërmjet komunës dhe organizatave joqeveritare, si edhe në bashkëpunimin ndërmjet sektorit privat dhe organizatave joqeveritare. Organizatat joqeveritare, me fleksibilitetin dhe dijen e tyre ia kanë dalur mbanë që të imponohen si faktorë domethënës, qoftë gjatë mobilizimit të akterëve, hartimit të projektpropozimeve por edhe në koordinim gjatë realizimit të projekteve.

### 3.4 KONKLUZIONI

Gjatë periudhës së shkurtër kohore Bashkimi Evropian ka investuar mjete domethënëse financiare në territorin e katër komunave në veri të Kosovës për projekte të cilat synon zgjidhjen e problemeve të ndryshme shoqëro-ekonomike. Në periudhën prej 6 viteve (2010-2016) BE-ja ka alokuar mbi 54,5 milionë euro për realizimin e 124 projekteve. Posaçërisht ia vlen të theksohet financimi i 79 projekteve në periudhën 2013-2016, në kuadër të dy skemave grant të cilat iu ishin dedikuar ekskluzivisht shfrytëzuesve nga komunat e vrojtura.

Parashtrohet pyetja logjike nëse janë arritur rezultatet proporcionalisht me mjetet e investuara, në të cilën kjo analizë e shkurtër gjithsesi nuk mund të jep përgjigje të qartë. Mirëpo, ekzistojnë më shumë indikatorë të cilët vënë në pah se prioritetet e integritetit të përsheptuar të komunave në veri në sistemin politiko-juridik të Kosovës mbizotëronin në raport me zgjidhjen e problemeve zhvillimore të komunave.

Pakoja e ndihmës financiare në veri të Kosovës pasoi pak para, e posaçërisht menjëherë pas nënshkrimit të marrëveshjes së Brukselit, në mënyrë që të inkurajohen qeveritë e sapozgjedhura lokale nga veriu i Kosovës që të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve të grumbulluara në territorin e vet. Prioritetet dhe mekanizmat e ndihmës financiare janë përcaktuar në procedurë të shpejtë, duke i treguar më shumë kujdes për distribuimin e mjeteve në afat sa më të shkurtër më shumë sesa efektet e dëshiruara afatgjata. Prandaj, janë shpërfillur faktet se nuk ekzistojnë kapacitete të mjaftueshme tek qeveritë lokale për të përzgjedhur dhe realizuar projektet strategjike të cilat do të kishin efekte domethënëse në zhvillimin shoqëro-ekonomik, posaçërisht jo për vëllimin e jashtëzakonshëm të mjeteve që janë vënë në dispozicion. Gjatë procesit të përzgjedhjes së projekteve dhe hartimit të aplikacioneve, komunat kanë pranuar ndihmë nga Agjencia Rajonale e Zhvillimit Veri si dhe nga këshilltarët e UNDP-së për kryetarët e komunave nga veriu i Kosovës, por kjo ndihmë nuk ka sjellur forcimin e kapacitetve administrative të qeverive lokale por është rritur kërkesa për ndihmën e jashtme teknike. Përveç kësaj, me projekte të komunës janë zgjidhur një varg të problemeve të rëndomta komunale dhe sociale, siç janë ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit dhe kanalizimit, objekteve publike, sanimit të rrugëve lokale, etj. gjë që do të ishte e dobishme për bashkësinë lokale por nuk ka sjellur ndryshime madhore në lëminë e zhvillimit ekonomik.

Ndihma financiare e BE-së gjithashtu ka mbështetur një numër të madh të subjekteve afariste të cilat kanë fituar ndihmë direkte të pakthyeshme për avancimin e afarizmit të vet. Me program është përcaktuar që mbështeten projektet në lëminë e bujqësisë dhe prodhimit të ushqimit, ndërsa sektorët tjerë nuk janë përfshirë me ndihmën. Rezultatet më domethënëse janë arritur përmes mbështetjes së Kooperativës Bujqësore në Zubin Potok, e cila ishte përfituese e disa projekteve të BE-së, si dhe të projekteve të donatorëve të tjerë. Mirëpo, në rastet tjera, kryesisht është fjala për mbështetje sipërmarrësve individual dhe bizneseve familjare, pa donjë ndikim të madh në punësim dhe zhvillim ekonomik.

Në kuadër të dy grante skemave, Bashkimi Evropian ka mbështetur dhjetë projekte për zhvillimin e sektorit joqeveritar, ku të gjithë përfituesit e këtij projekti janë nga Mitrovica Veriore. Kjo ka bërë që aktivitetet e organizatave joqeveritare në Mitrovicën e Veriut të jenë shumëfish më të mëdha sesa në komunat tjera, dhe me këtë edhe dukshmëria e Bashkimit Evropian në këtë komunë është dukshëm më e madhe sesa në komunat tjera. Mirëpo, është me rëndësi të theksohet se disa organizata joqeveritare kanë përfituar nga mjetet e BE-së e që kishin të bënin me lëmi të tjera, para se gjithashtu zhvillimi ekonomik dhe bujqësor.

Kur është fjala për dukshmërinë e ndihmës financiare të BE-së në veri të Kosovës, fitohet përshtypja e përgjithshme se ajo nuk është proporcionale me madhësinë e mjeteve të investuara. Më pak të dukshme janë projektet të cilat realizohen nga sektori privat për të cilat në përgjithësi dihet shumë pak në opinion, ndërsa më të dukshëm janë projektet e organizatave joqeveritare të cilët shpesh janë të pranishëm në mediat lokale dhe në rrjetet shoqërore. Dukshmëria e projekteve të cilat i realizojnë komunat në mënyrë direkte varet nga vullneti politik i qeverisë lokale për të promovuar investimet e BE-së në territorin e tyre. Mirëpo, gjithsesi vërehet një trend pozitiv tek liderët lokal politik, organizatat joqeveritare dhe në mediat tek veriu i Kosovës që, në mënyrë më aktive, të kyçen në promovimin e projekteve të cilat financohen nga BE.

# FONDI PËR ZHVILLIMIN E VERIUT TË KOSOVËS

# 4



#### 4.1 HYRJE

Takimi i parë i përfaqësuesve të Beogradit dhe Prishtinës që nga shpallja e njëanshme e pavarësisë së Kosovës është mbajtur në Bruksel në mars të vitit 2011. Pothuajse dy vite më vonë, në janar të vitit 2013, dialogu rezultoi me vendimin për themelimin e Fondit për zhvillimin e komunave veriore (Fondi) në kuadër të marrëveshjes për doganë.

Qëllimi i themelimit të fondit është që të mbështetet zhvillimi shoqëroro-ekonomik në katër komunat e veriut të Kosovës: Leposaviq, Mitrovica e veriut, Zubin Potoku dhe Zveçani. Mjetet për fond sigurohen nga të hyrat doganore të mbledhura nga vendkalimi 1 (Jarinje) dhe 31 (Brnjak) nga doganimi i mallit i cili i dedikohet veriut të Kosovës si dhe nga doganimi i mallit të ndërmarrjes të cilat janë të regjistruara në katër komunat nga veriu i Kosovës.

Deri në fund të gushtit 2016, në Fond janë mbledhur më shumë se 9,4 milionë Euro, ndërsa deri atëherë, Këshilli drejtues ka miratuar 22 projekte të ndryshme me vlerë të përgjithshme prej rreth 7,5 milionë eurove. Pjesa më e madhe e projekteve janë në fazën e realizimit, ndërsa një numër i caktuar i projekt propozimeve është kthyer për përpunim teknik dhe ri-parashtrim para Bordit menaxhues.<sup>7</sup>

Në vazhdim do të jepet një pasqyrë e shkurtër e themelimit dhe funksionimit të Fondit, e gjithashtu do të analizohet vëllimi i mbështetjes së komunave në veri të Kosovës nga ana e këtij Fondi.

#### 4.2 FUNKSIONIMI I FONDIT PËR ZHVILLIMIN E VERIUT TË KOSOVËS

Për funksionimin e Fondit vendos Këshilli Udhëheqës. Këshilli drejtues i Fondit është themeluar në dhjetor të vitit 2014, dhe përbëhet nga Përfaqësuesi special i BE-së në Kosovë si kryesues, Ministri i Financave i Kosovës në emër të Qeverisë së Kosovës si dhe përfaqësuesi i bashkësisë serbe të katër komunave nga veriu i Kosovës.

Në mars të vitit 2015, Këshilli drejtues ka njoftuar se Fondi është bërë operativ dhe se kryetarët ftohen të parashtrajnë projekt propozimet për zhvillimin e komunave të veta të cilat duhet të kenë ndikimi direkt në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve nga këto komuna. Për mjetet nga Fondi së pari ka aplikuar komuna e Mitrovicës së Veriut, ndërsa në xhirot pasuese janë paraqitur edhe tre komuna ((Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq).

Dogana për mallin e dedikuar për veriun e Kosovës paguhet në vend kalimet kufitare në ekspoziturën e Raiffeisen bankës, ndërsa çdo fletëpagesë ka vulë të veçantë *Fondi Zhvillimor*, që do të thotë se këto të holla të arkëtuara orientohen kah Fondi për zhvillim të veriut të Kosovës. Kur mblidhet një shumë e caktuar e të hollave, komunat i parashtrajnë projekt propozimet në shqyrtim Bordit drejtues. Kur miratohet ndonjë projekt, të hollat për realizimin e tij së pari kalojnë në një llogari të veçantë në bankën NLB Prishtina. Pas kësaj, Kryesuesi i Bordit drejtues lëshon urdhër për transfer të hollave nga banka në Thesar, nga ku të hollat barten në llogarinë e komunës. Për zbatim të projekteve janë përgjegjëse komunat dhe obligohen që Bordit Drejtues t'i parashtrajnë raport të fundit dhe të audituar për secilin projekt.

Projektet të cilat financohen nga Fondi mund të jenë projekte për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës publike (rrugët, spitalet, ujësjellësi, trajtimi i ujërave të zeza dhe menaxhimi i mbeturinave), mbështetja ndërmarrjeve, bujqve dhe shoqërisë civile, promovimin e të drejtave të njeriut, arsimin, qasje në mbrojtje shëndetësore dhe transport.


<sup>7</sup> Ueb faqja e Zyrës së BE-së në Kosovë <http://bit.ly/2creuUD>

Nuk ka ndonjë kornizë kohore brenda së cilës duhet të shpenzohen të hollat nga Fondi, ashtu që thirrja për parashtrimin e projekt propozimeve është gjithnjë i hapur.

#### 4.3 PASQYRA E PROJEKTEVE TË MIRATUARA TË FONDIT


Që nga fillimi i funksionimit të Fondit, Bordit drejtues i janë parashtruar për shqyrtim gjithsej 35 projekt propozime. Deri tash janë miratuar gjithsej 22 projekte, për financimin e të cilëve janë ndarë mjetet e Fondit dhe atë në pesë raunde. Më së shumti mjete i janë ndarë komunës së Mitrovicës së veriut (2,915,190 Euro apo 39%), pastaj komunës së Leposaviqit (1,661,282 apo 22%) pastaj komunës së Zveçanit (1,581,638 Euro apo 21%) dhe në fund komunës së Zubin Potokut (1,397,533 Euro apo 18%).

**Grafiku 11:** Pasqyra e ndarjes së mjeteve të Fondit sipas komunave



Komunës së Mitrovicës së Veriut i janë miratuar gjithsej 5 projekte në vlerë të përgjithshme prej 2,915,190 Euro. Në raundin e parë, për projektin “Eksproprijimi i tokës për ndërtimin e objektit të ri të Komunës” janë ndarë 604,000 Euro, për projektin “Ndërtimi i objektit të zjarrfikësve” 603,900 Euro, ndërsa për projektin “Mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” 399,490 Euro. Në raundin e dytë, komunës së Mitrovicës së Veriut i është miratuar projekti “Ndërtimi i sallës së sporteve” në vlerë 907,000 Euro, ndërsa në raundin e tretë të ndarjes së mjeteve nga Fondi, komuna ka pranuar 399,900 Euro për projektin “Instituti Regjional Kulturor”.


**Grafiku 12:** Projektet e komunës së Mitrovicës së Veriut sipas kategorive






Për 7 projektet e miratuara, komunës së Zveçanit i janë ndarë 1,581,638 Euro. Për projektin “Eksproprijimi i tokës për rrugën e qasjes deri te Deponia Regjionale” komunës i janë miratuar 350,000 Euro, për projektin “Mbështetja organizatave të shoqërisë civile përmes aktiviteteve sportive dhe kulturore” 79,648 euro, për projektin “Mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme” 206,500 Euro, për projektin “Mbështetje ekonomive bujqësore dhe zhvillimit të prodhimit të qëndrueshme bujqësore” 203,700 Euro. Në raundin e tretë komunës i janë miratuar projektet “Eksproprijimi i tokës dhe ndërtimi i qendrës rinore” në shumën prej 355,600 Euro, si dhe projekti Pastrimi i deponisë ilegale industriale Gater. Vlera e këtij projekti është 97,000 Euro. Shuma e fundit e miratuar për komunën e Zveçanit është 289,189 Euro dhe i dedikohet projektit “Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit, rrjetit të energjisë elektrike dhe infrastrukturës rrugore” për 10 shtëpi të rasteve sociale, ndërtimin e të cilëve e ka financuar Ministria për punë dhe mirëqenie sociale, si dhe për 20 shtëpi shtesë për personat e zhvendosur intern, ndërtimin e të cilëve e financoi Ministria për punë dhe kthim.

**Grafiku 13:** Projektet e komunës së Zveçanit sipas kategorive




Komunës së Zubin Potokut i janë miratuar katër projekte në shumën e përgjithshme prej 1,397,533 Euro, dhe atë për projektin “Ndërtimi i bazenit të hapur”, vlera e të cilit është 439,695 Euro, projektin “Ndërtimi i arenës së atletikës” në vlerën prej 122,604 Euro, projektin “Renovimi i rrjetit të rrugëve lokale” në vlerën 426,233 Euro dhe projektin “Zhvillimi ekonomik i komunës përfshirë edhe zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, mbështetje bujqësisë dhe vetë-punësimit” në vlerën e përgjithshme prej 409,000 Euro.

**Grafiku 14:** Projektet e komunës së Zubin Potokut sipas kategorive




Komunës së Leposaviqit i janë miratuar mjete për 6 projekte me vlerë të përgjithshme prej 1,661,282 Euro. Për projektin “Mbështetje ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme dhe zhvillimi i bujqësisë” janë miratuar 544,985 Euro. Janë miratuar edhe projektet “Ndërtimi dhe renovimi i objekteve për aktivitete kulturore dhe sportive” në vlerë prej 220,497 Euro dhe “Ndërtimi dhe renovimi i rrugëve lokale të pa-kategorizuara” me shumën prej 280,897 Euro, ndërsa për projektin “Furnizimi i kopshtit të fëmijëve” janë ndarë 140,000 Euro. Në takimin e fundit të Bordit drejtues, komunës së Leposaviqit i janë miratuar edhe dy projekte, dhe atë “Ndërtimi dhe renovimi i rrugëve lokale” në shumën prej 414,650 Euro dhe “Blerja e pajisjeve shtesë për kopshtin e fëmijëve” në shumën prej 60,253 Euro.

**Grafiku 15:** Projektet e komunës së Leposaviqit sipas kategorive




Më shumë se gjysma e projekteve të Fondit janë orientuar në zhvillimin e infrastrukturës së komunave, konkretisht 59%. Vlera e këtyre projekteve është 5.415.066 Euro. Shuma e mbetur është orientuar në sektorë të tjerë. Për të katër komunat, përmes tri projekteve të mbështetjes për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, janë miratuar mjete në shumën prej 1,559,975 Euro. Për mbështetje të organizatave të shoqërisë civile, janë miratuar 79,648 Euro, për mbështetjen e bujqësisë 203,700 Euro ndërsa për furnizim të pajisjeve, në këtë rast për furnizim të kopshtit të fëmijëve në komunën e Leposaviqit, janë ndarë 200,253 Euro.

**Grafiku 16:** Ndarja e mjeteve të Fondit sipas sektorëve



Edhe pse komuna e Zveçanit ka më shumë projekte të aprovuara në raport me komnat tjera, në këtë komunë nuk janë orientuar më së shumti mjete, pasi që vlera mesatare e projekteve është më e ulët në krahasim me këto komuna. Mesatarisht, vlerë më të madhe financiare kanë komnat e Mitrovicës së Veriut.

**Grafiku 17:** Vlera mesatare e projektit sipas komunave (në euro)



Komuna e Mitrovicës së Veriut, Zveçanit dhe Leposaviqit kanë nënshkruar Memorandume të bashkëpunimit me Agjencinë rajonale për zhvillim për Veriun (RDA North) për realizim të projekteve të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, edhe pse detajet teknike të këtij bashkëpunimi ende nuk janë saktësuar. Sa i përket projekteve infrastrukturore, komnat aktualisht janë në fazë të përgatitjes për shpalljen e tenderit. Një prej projekteve të rralla, i cili është në fazën e fundit të realizimit është projekti “Ndërtimi i arenës së atletikës” në Zubin Potok.

#### 4.4 KONKLuzionET

Fondi për zhvillim paraqet një prej instrumenteve më konkrete të mbështetjes së zhvillimit të komunave në veri të Kosovës që rrjedhin nga Marrëveshja e Brukselit, i hartuar si përgjigje ndaj protestave shumë-vjeçare të qytetarëve dhe refuzimi i ndërmarrjeve nga veriu i Kosovës që të paguajnë doganë dhe tatime në pikë kalimet Jarinje dhe Brnjak. Ky instrument gjithashtu paraqet një formë të decentralizimit fiskal, i cili gjithsesi do të jetë objekt i bisedave të shumta në vitet e ardhshme, posaçërisht duke pasur parasysh se baza ligjore për themelimin e Fondit nuk është përcaktuar në mënyrë përfundimtare.

Fondi është në dispozicion vetëm për qeveritë lokale por jo edhe shfrytëzuesve të tjerë nga sektori publik (shkollat, spitalet, institucionet kulturore, etj.), organizatave joqeveritare, organizatave ndërkombëtare, agjencive zhvillimore apo sektorit privat. Me këtë qartazi i është bërë me dije opinionit publik se themeluesit e Fondit i shohin qeveritë lokale si bartës të vetëm të zhvillimit të veriut të Kosovës, duke përjashtuar kështu rolin domethënës dhe kapacitetet e akterëve të tjerë, të cilët merren me çështje me rëndësi për zhvillimin shoqëroro-kulturor të katër komunave.

Është vërejtur një transparencë e pamjaftueshme e punës së Fondit, para se gjithash në domenin e shpalesjes publike të qëllimeve, prioriteteve dhe masave mbi bazën e të cilëve përzgjidhen projektet. Dokumentet me të cilët rregullohet puna e Fondit nuk janë në dispozicion për opinionin publik, ashtu që qytetarëve nuk u janë vënë në dispozicion informata se çka synohet të arrihet me investime nga ky burim. Në anën tjetër, pas çdo takimi të Bordit Drejtues, Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë njofton publikun për projektet e miratuara dhe shumën e mjeteve të ndara sipas komunave, gjë që paraqet të vetmet informata në dispozicion lidhur me punën e Fondit.

Qeveritë lokale gjithashtu nuk janë transparente sa duhet në komunikim me qytetarë lidhur me atë se si përzgjidhen projektet për financim në kuadër të Fondit, dhe as cilat janë qëllimet dhe rezultatet e pritura, të cilat janë parashtruar dhe miratuar. Shumica e projekteve të miratuara nuk janë komponentë të qartë zhvillimore por kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin e infrastrukturës komunale, rrugore, sportive apo objekteve me rëndësi publike (kopshtet, qendrat rinore dhe kulturore). Duke pasur parasysh se në vitin 2015, Qeveria e Kosovës ka miratuar mbi 15 milionë euro për financimin e projekteve kapitale infrastrukturore në këto katër komuna, parashtrohet pyetja e validitetit të këtij vëllimi të investimeve në zhvillim të infrastrukturës nga Fondi për zhvillim. Duke pasur parasysh se komunat nuk kanë kapacitete të mjaftueshme administrative dhe teknike për punë në projekte të këtyre përmasave dhe niveli të kompleksitetit, gjë që është dëshmuar, ndër të tjera, edhe në kuadër të dy kapitujve praktikë të këtij studimi, është e sigurt se do të ketë probleme me vonesa gjatë realizimit të projekteve.

Në çdo komunë është miratuar nga një projekt i cili synon zhvillimin e sipërmarrësisë, ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme. Mirëpo, nuk ka as edhe një informatë publike lidhur me atë se cilat janë qëllimet e këtyre projekteve, si do të bëhet përzgjedhja e përfituesve, cilët sektorë do të mbështeten, e kështu me radhë. Tre komunat (Leposaviqi, Mitrovica e Veriut dhe Zveçani) kanë iniciuar biseda me RDA North rreth menaxhimit të këtyre mjeteve, por është interesant se këto negociata kanë filluar vetëm pas miratimit të projekteve nga ana e Fondit. Dhe prandaj parashtrohet pyetja logjike se pse Fondi ka miratuar këto projekte nëse ata nuk ishin të përgatitur sa duhet për realizim apo nëse përfituesit nuk kanë pasur kapacitete të mjaftueshme për realizimin e tyre?

Nga sa u tha më lartë, mund të konstatohet se vëmendja më e madhe i është dhënë shpërndarjes së mjeteve në dispozicion sesa efekteve zhvillimore të cilat synohen të arrihen me financimin nga Fondi për zhvillim.

A JETOJMË MË MIRË?

5



Që nga nënshkrimi i Marrëveshjes së Brukselit (prill 2013) e deri në ditët e sotme, në kuadër të tre burimeve të vrojuara të financimit, janë ndarë mbi 32 milionë euro për realizimin e 249 projekteve. Nga kjo, parashtrohet pyetja logjike: A i kanë kontribuar këto investime dhe projektet e zgjedhura përmirësimit të cilësisë së jetës në veriun e Kosovës? Duke pranuar faktin se nuk ka një përgjigje e thjeshtë në këtë pyetje, kjo pjesë përmbyllëse synon të ofrojë shpjegim i cili, deri në një masë, mund të ofrojë një pasqyrë reale lidhur me efektet e ndihmës financiare për komunat e vrojuara.

**Ndihma financiare për komunat në veri të Kosovës, para se gjithash, kishte për qëllim të ofrojë mbështetje politike për pjesëtarët e qeverive të zgjedhura lokale në Leposaviq, Mitrovicë të Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan në proceset e integritit në sistemin juridik të Kosovës,** ndërsa aspektet tjera (ekonomik, shoqëror, institucional) kanë qenë në plan të dytë. Edhe pse të gjithë akterët e kishin të qartë që komunat në veri të Kosovës nuk kanë kapacitete teknike dhe administrative për përzgjedhjen dhe realizimin e projekteve të përmasave të tilla, fitohet përshtypja e përgjithshme se me investime financiare është synuar të sigurohet mbështetja politike për bartësit e funksioneve politike, të cilët ishin zgjedhur në zgjedhjet e para lokale sipas sistemit kosovar. Prandaj, nuk habit fakti se në kuadër të projekteve të financuara nga Qeveria e Kosovës, norma e realizimit të projekteve në shumicën e komunave (përveç të Zubin Potokut) është më e ulët se 50%, pasi që komunat e vrojuara nuk kishin kapacitete që të realizojnë projektet e miratuara përbrenda afatit të paraparë ligjor.<sup>8</sup>

**Përzgjedhja e projekteve të mbështetura vihet në pikëpyetje për të gjitha fondet e vrojuara, posaçërisht nuk kuptim të nxitjes së zhvillimit ekonomik të veriut të Kosovës.** Asnjë komunë nuk ka pasur qasje strategjike në përzgjedhjen e projekteve, të cilat do të sillnin deri te zhvillimi ekonomik. Ato kanë sugjeruar dhe përfituar projekte të cilat kryesisht kishin të bënin me punë infrastrukturore, ku prijnë investimet në asfaltimin e rrugëve lokale, ndërtimi dhe renovimi i objekteve publike dhe sportive dhe ndërtimi i objekteve banesore për rastet sociale. Këto projekte mund t'i kontribuojnë cilësisë së jetës por nuk do të kenë ndikim në zhvillimin e sektorit privat apo uljes së papunësisë. Gjithashtu, ekziston frika e investimit të tepër në objekte publike, të cilat më vonë nuk do të mund të mirëmbahen me mjete të rregullta. Në anën tjetër, Bashkimi Evropian ka mbështetur zhvillimin e ndërmarrësisë së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, por pjesa më e madhe e këtyre projekteve nuk kanë sjellur rezultate domethënëse në rritjen e të punësuarve, zhvillimit të sektorit privat apo edhe rritjes së të hyrave tatimore në territorin e këtyre komunave.

**Ndihma financiare për komunat në veri të Kosovës nuk i ka kontribuar thellimit të dialogut shoqëror lidhur me pyetjet me rëndësi për zhvillimin e bashkësive lokale, dhe as pyetjeve të tjera siç janë fuqizimi i demokracisë dhe përgjegjësia e qeverive lokale.** Realizimin e projekteve e kanë koordinuar kryesisht kryetarët me shërbimet e tyre profesionale, duke ofruar shumë pak informata për publikun se si janë përzgjedhur projektet, nga cilat burimet e financimit apo edhe statusin e realizimit të projekteve. Në shumë raste, kryetarët nuk kanë njoftuar as kuvendet komunale me listat e projekteve që janë parashtruar për financim, e posaçërisht me statusin e realizimit të tyre. Asnjë qeveri lokale nuk ka komunikuar me qytetarë në asnjë fazë të ciklit të projekteve, që nga përzgjedhja, tek kërkimi i mjeteve financiare, realizimi e deri te informimi lidhur me rezultatet

<sup>8</sup> Përveç kësaj në kuadër të investimeve të Qeverisë së Kosovës mjetet janë ndarë në bazë të numrit të banorëve e jo cilësisë së projekteve, një kriter që nuk do të krijojë efekte afatgjate.

e arritura në fund. Posaçërisht janë fshehur informata lidhur me burimin e financimit për projektet realizimin e të cilëve e ka mbështetur Qeveria e Kosovës, duke arsyetuar këtë akt me motive politike dhe jo-popullaritetin e Qeverisë së Kosovës në mesin e qytetarëve të veriut të Kosovës.

**Përfaqësuesit e qeverive lokale nuk kanë shfrytëzuar realizimin e këtyre projekteve për t'u shpjeguar më afër qytetarëve ndryshimet politike dhe shoqërore të cilat kanë ndodhur në veri të Kosovës pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Brukselit, posaçërisht pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale në veri të Kosovës.** Edhe pse në paraqitjet publike të tyre, kryetarët dhe përfaqësues të tjerë eminentë të qeverive lokale theksojnë rëndësinë e projekteve individuale të cilat janë financuar në komunat e tyre, kryesisht shpërfilllet historia e cila ka të bëjë me proceset integruese në sistemin politiko-juridik të Kosovës, me çka opinionit vazhdohet t'i ofrohet pamja e një realiteti të ndarë në raport me funksionimin e pushtetit lokal.<sup>9</sup>

Edhe njëherë i kthehemi pyetjes: A jetojmë më mirë? Është i pamohueshëm fakti se investimet në veri kanë avancuar (apo do ta avancojnë) cilësinë e jetës së qytetarëve në kuptim të infrastrukturës komunale, shoqërore dhe sportive. Në anën tjetër, rezultatet e hulumtimeve të paradokohshme lidhur me qëndrimet e qytetarëve të veriut të Kosovës, të cilat i kanë realizuar organizatat joqeveritare dhe mediat, vënë në dukje se qytetarët e katër komunave kanë një perceptim mjaft negativ për Marrëveshjen e Brukselit,<sup>10</sup> cilësinë e jetës dhe perspektivës ekonomike, ku pesimizimi është posaçërisht i theksuar tek të rinjtë.<sup>11</sup> Këto hulumtime tregojnë se pavarësisht nivelit të investimeve dhe numrit të projekteve, qytetarët edhe më tej janë të brengosur për shkak të proceseve të tranzicionit dhe pasigurisë që janë pasojë e mungesës së transparencës dhe sinqeritetit të akterëve të cilët marrin pjesë në jetën politike, jo vetëm në komunat në veri të Kosovës por edhe në Prishtinë dhe Beograd. Nga kjo, mund të thuhet se pa stabilitetin politik, qeverive të përgjegjshme dhe transparente lokale, me kapacitete të fuqizuara dhe perspektivë të qartë për zhvillim ekonomik, çfarëdo mjete të investuara në vitet paraprahe (dhe ato që do të investohen në të ardhmen) nuk do të realizojnë efektet afatgjate pozitive në jetën e qytetarëve në katër komunat e vrojtuar të veriut të Kosovës.

<sup>9</sup> Shembulli më të mirë për këtë ilustron nga diskutimet që janë bërë gjatë TV debateve me përfaqësuesit e udhëheqësive lokale. Kur është biseduar për lëshimin të lejeve të ndërtimit për objektet që janë ndërtuar në kuadër të projekteve të përcjellura, janë dëgjuar përgjigje të ndryshme nga ato: komunat nuk leshojnë leje ndërtimi, e deri te ato se lejet lëshohen në kuadër të Ligjit për planifikim të ndërtimit të Republikës së Serbisë. TV Debatet kanë qenë pjesë përbërëse e projektit në kuadër të të cilit është bërë ky studim. Këto debate mund të shikohen në kanalën e youtube të RTV Mir nga Leposaviq.

<sup>10</sup> Në kuadër të emisionit televiziv "Serbët nga Kosova për marrëveshjen e Brukselit", që është transmetuar në rrjetin e RTV Mir në fund të vitit 2016, janë prezantuar disa sutudime, të qëndrimeve të qytetarëve nga veri i Kosovës të bëra nga mediet dhe OJQ-të, në to në përgjithësi shprehet mosbesimi në procesin e Brukselit (<http://bit.ly/2dkVVqo>)

<sup>11</sup> Në kuadër të hulumtimit "Të rinjtë pyeten", që është bërë në mars të vitit 2016, nga OJQ Sinergjia nga Mitrovica Veriore, 81 për qind të të anketuarëve të moshës 15-30 vjeç dshirojnë ta lëshojnë veriun e Kosovës (<http://bit.ly/2dbpANI>, faqe 13)



**Rekomandimet:**

**Komunave në veri të Kosovës:**

- Të hartohen plane afatgjate strategjike të zhvillimit me plane të veprimit, të cilët do të përqendrohen në shfrytëzimin e potencialit dhe mundësive për zhvillim ekonomik, zhvillim të sektorit privat dhe krijim të vendeve të reja të punës. Këto plane strategjike dhe të veprimit të hartohen në konsultim me përfaqësues të sektorit privat, organizatave joqeveritare dhe opinionin publik profesional;
- Të hartohen planet afatgjate për zhvillim të projekteve kapitale të infrastrukturës, me plane të veprimit. Për të gjitha projektet kapitale, të hartohet analiza e kosto-profit (shpenzim-dobi), studimin e fizibilitetit dhe dokumentacionin projektues-teknik;
- Të fuqizohen mekanizmat për përgjegjësi më të madhe të bartjes së funksioneve publike në qeveritë lokale për punët e ndërlidhura me projekte;
- Të organizohet puna e shërbimeve profesionale dhe të zhvillohen kapacitetet e qeverive lokale për punë në hartimin dhe realizimin e projekteve. Në këtë aspekt, është e nevojshme të formohet një shërbim i veçantë komunal në kuadër të kabinetit të kryetarit, e cila do të merrej me çështje të ndërlidhura me projekte.
- Të avancohet transparenca në punën e shërbimeve komunale dhe të vihet komunikimi i rregullt me qytetarë. Për fillim, është e nevojshme që secila komunë të hartojë një ueb faqe komunale përmes së cilës do të njoftojë qytetarët për punën e vet, ndërsa më vonë të vihet praktika e takimeve të rregullta me qytetarë ku do të bisedohet për pyetjet e ndryshme të lidhura me zhvillimin e qeverive lokale;
- Bartësit e funksioneve ekzekutive në komuna të përmbahen nga dërgimi i mesazheve politike të cilat mund të prodhojnë jostabilitet politik, institucional dhe të sigurisë. Gjithashtu, është e nevojshme të punohet në forcimin e mjedisit, zgjerimi të kuadros pozitive për komunitat e veriut të Kosovës dhe tërheqjes së investimeve të jashtme.

**Qeverisë së Kosovës:**

- Të vihet në funksion buxheti shumë-vjeçar në mënyrë që të krijohen kushte për realizimin e projekteve komunale në më shumë cikle buxhetore;
- Të rritet transparenca dhe qasshmëria e të dhënave publike për projektet e financuara nga Buxheti i Qeverisë së Kosovës;
- Të bëhen investime në komunitat e veriut të Kosovës me shuma të parashikueshme buxhetore, të cilat përcaktohen për së paku tre vite të njëpasnjëshme;
- Të rritet prania në veri të Kosovës, posaçërisht në komunikim me qytetarët.

**Bashkimit Evropian:**

- Të fuqizohet prania në veri të Kosovës, posaçërisht në diplomaci publike dhe në komunikim të drejtpërdrejt me qytetarët. Është posaçërisht me rëndësi të komunikohet më me intensitet me qytetarët lidhur me rolin e Bashkimit Evropian në Marrëveshjen e Brukselit dhe për efektet e ndihmës financiare komunave në veri të Kosovës. Lidhur me këtë, gjithashtu është e nevojshme të kryhet një vlerësim i pavarur i efekteve të projekteve të mbështetura në kuadër të skemave të granteve për veriun e Kosovës, rezultatet e së cilës do të shfrytëzoheshin në diplomacinë publike;
- Të hartohet dhe të mbështetet projekti regjional për fuqizimin e kapaciteteve të administratave komunale në veri të Kosovës;
- Të reformohet puna e Agjencisë Regjionale për Zhvillim Veri, të fuqizohet dhe mbështetet pjesëmarrja e komunave nga veriu i Kosovës në punën e kësaj agjencie dhe të mbështetet hartimi i Strategjisë së re Regjionale të Zhvillimit në Regjionin Veri;
- Të kryhet vlerësimi i situatës së sigurisë në veri të Kosovës dhe të punohet në eliminimin e kufizimeve të lëvizjes për personelin e Bashkimit Evropian dhe EULEX-it.



SHTOJCAT



**Shtojca 1: PERSONAT E INTERVISTUAR**

Emri i personit	Pozicioni	Vendi
Marija Nedeljković	Përfaqësuesi i posaçëm i BE-së	Mitrovicë e Veriut
Žarko Kovačević	Projekt menaxher në ADRA	Mitrovicë e Veriut
Zoran Todić	Kryetar i Kuvendit Komunal Leposaviq	Leposaviq
Zoran Mojsilović	Këshilltar i Ministrit për qeverisje lokale	Mitrovicë e Veriut
Christof Stock	Shef i operimeve BE	Prishtina
Danijela Marjanović	Antarë i këshillit drejtues të Fondit për zhvillim	Mitrovicë e Veriut
Ljubiša Mijačić	Këshilltar i Kryetarit të Komunës Zubin Potok	Zubin Potok
Miloš Vukadinović	Këshilltar i Kryetarit të Komunës Leposaviq	Mitrovicë e Veriut
Besnik Osmani	Zëvendës ministër për administrim lokal	Prishtina
Jelena Đokić	Këshilltar i Kryetarit të Komunës Zveçan	Mitrovicë e Veriut
Nataša Elezović	Këshilltar i Kryetarit të Komunës Mitrovicë Veriore	Mitrovicë e Veriut
Dragan Pešaković	Inxhinjer i ndërtimtarisë komuna Leposaviq	Leposaviq
Radoš Mihajlović	Këshilltar komunal Leposaviq	Leposaviq
Besim Kamberaj	Shef i sektorit për bashkëpunim dhe zhvillim rajonal	Prishtina
Jelena Milenković	Zyra administrative Zubin Potok	Mitrovicë e Veriut

## Shtojca 2: INFOGRAFIKAT

# GRANT SKEMAT E BE-SË PËR VERI TË KOSOVËS



1.805.403 €

10 OJQ



3.777.962 €

4 komuna

3.920.270 €

60 kompani private

## NUMRI I PROJEKTEVE NËPËR KOMUNA



## SEKTORËT MË TË PËRFAQËSUAR PËR KOMUNË

ZUBIN POTOK

BUJQËSI

83,4%

LEPOSAVIQ

BUJQËSI

82,7%

MITROVICË VERIORE

ZHVILLIM EKONOMIK

47,4%

ZVEÇAN

BUJQËSI

50%

Finansuar nga:

Zbatuar nga:



# FONDI PËR ZHVILLIMIN E VERIUT TË KOSOVËS

JANË MBLEDHUR MË SHUMË SE 9,4 MILIONË EURO

JANË APROVUAR 22 PROJEKTE NË VLERË PREJ RRETH 7,5 MILIONË EURO

1.661.282 €

LEPOSAVIQ

1.581.637 €


ZVEÇAN

1.397.532 €

ZUBIN PËTOK

2.915.190 €

MITROVICË VERIORE



## PROJEKTET SIPAS SEKTORIT



## NUMRI I PROJEKTEVE PËR KOMUNË, PJESËMARRJA NË PROJEKTE

ZVEÇAN  
7 PROJEKTE

INFRASTRUKTURË 57%

MITROVICË VERIORE  
5 PROJEKTE

INFRASTRUKTURË 80%

LEPOSAVIQ  
6 PROJEKTE

INFRASTRUKTURË 50%

ZUBIN POTOK  
4 PROJEKTE

INFRASTRUKTURË 75%

Finansuar nga:



Zbatuar nga:





# MJETET FINANSIARE TË QEVERISË SË KOSOVËS PËR PROJEKTE KAPITALE PËR UDHËHEQJEN LOKALE NË VERI TË KOSOVËS PËR VITIN 2015

**QEVERIA E KOSOVËS**

**15.170.000 €**

**NUMRI I PROJEKTEVE SIPAS MINISTRISË**

MINISTRIA	NUMRI I PROJEKTEVE	FONDET E KËRKUARA
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS	20	3.651.000 €
MINISTRIA E SHËNDËTËSISË	6	999.995 €
MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT	8	1.270.000 €
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	21	2.000.000 €
MINISTRIA E PUNËS DHE ÇËSHTIEVE SOCIALE	7	1.250.000 €
MINISTRIA E AMBIJENTIT DHE PLANIFIKIMIT HAPSOR	17	1.898.000 €
MINISTRIA E KTHIMIT DHE E KOMUNITETEVE	30	4.251.000 €
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT DHE QEVERISJES LOKALE	39	983.815 €

**4.858.955 €**

LEPOSAVIQ

**4.099.800 €**

MITROVICË VERIORE



**3.097.610 €**

ZUBIN POTOK

**3.997.445 €**

ZVEÇAN

**21,3%**

LEPOSAVIQ

**47,8%**

MITROVICË VERIORE



**100%**

ZUBIN POTOK

**48,6%**

ZVEÇAN

**MJETET E SHPENZUARA**

## SEKTORET MË TË PËRFAQËSUARA

KOMUNIKACION **4.277.855 €**

MBROJTJE SOCIALE **2.560.000 €**

ARSIM **2.194.870 €**

TË RINJTË, SPORTI DHE REKREACIONI **1.770.610 €**




Finansuar nga:

Zbatuar nga:



# PËRKRAHJA FINANSIARE E BE-SË PËR VERIUN E KOSOVËS



## NUMRI I PROJEKTEVE NËPËR KOMUNA



1 PROJEKTE NDËR-KOMUNALE

Finansuar nga:



Zbatuar nga:





# NDIHMA FINANCIARE NË VERI TË KOSOVËS PAS NËNSHKRIMIT TË MARRËVESHJES SË BRUKSELIT



## SHFRYTEZUESI I MJETEVE FINANCIARE



## PROJEKTET SIPAS SEKTORIT



## VLERA E PROJEKTEVE TË REALIZUARA NË KOMUNA



Projekti financohet nga:

Zbatimi:



## SHTOJCA 3: LISTA E PROJEKTEVE

NR	Burimi i finansimit	Shfrytëzuesi	Emri i projektit	Komuna	Kategoria	Vlera e projektit Euro
1	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Mitrovica Veriore	Rekonstruimi dhe sanimi i infrastrukturës rrugore	Mitrovicë Veriore	Infrastrukturë	330.000,00
2	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Mitrovica Veriore	Rekonstruimi dhe sanimi i ndriçimit publik	Mitrovicë Veriore	Infrastrukturë	170.000,00
3	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Mitrovica Veriore	Punimi mbikqyrja dhe pranimi teknik i projekteve	Mitrovicë Veriore	Infrastrukturë	100.000,00
4	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Leposaviq	Asfaltimi i rrugëve të pakategorizuara në fshatrat e Leposaviqit	Leposaviq	Infrastrukturë	668.805,00
5	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Leposaviq	Rekonstruimi dhe asfaltimi i rrugëve në zonat urabne në Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	325.195,00
6	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i rrugës lokale për fshatin Graniçan	Leposaviq	Infrastrukturë	50.000,00
7	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Leposaviq	Regullimi i rrugës ekzistuese Belo Bërdo-Leshak	Leposaviq	Infrastrukturë	50.000,00
8	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i rrugës për në varezat e fshatit Koporiçë	Leposaviq	Infrastrukturë	7.000,00
9	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i rrugëve të pa kategorizuara në Zubin Potok	Zubin Potok	Infrastrukturë	180.000,00
10	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i trotoreve nga Uglari deri në Zubin Potok	Zubin Potok	Infrastrukturë	120.000,00
11	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i rrugëve në lagjen Zupç	Zubin Potok	Infrastrukturë	150.000,00
12	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi dhe rekonstruimi i rrugëve në lagjen Veli Breg	Zubin Potok	Infrastrukturë	100.000,00
13	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i ndriçimit publik në lagjen Zubin Potok	Zubin Potok	Infrastrukturë	220.000,00
14	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i ndriçimit publik në lagjen Zupç	Zubin Potok	Infrastrukturë	130.000,00
15	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Rekonstruimi i udhëkryqeve	Zubin Potok	Infrastrukturë	150.000,00
16	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i rrugës Jeshan me ndriçim në Zubin Potok	Zubin Potok	Infrastrukturë	200.000,00
17	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi dhe rekonstruimi i rrugëve dhe ndriçimit në lagjen e re Veli Breg	Zubin Potok	Infrastrukturë	150.000,00
18	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Asfaltimi dhe ndërtimi i rrugës në lagjen Gazivoda	Zubin Potok	Infrastrukturë	100.000,00
19	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zubin Potok	Regullimi i i udhëkryqit në hyrje të Zubin Potokut me kalim për këmbësorë	Zubin Potok	Infrastrukturë	100.000,00
20	Ministria e Infrastrukturës	Komuna Zveçan	Ndërtimi i urës Valaç-Srboc me rugën përskaj	Zveçan	Infrastrukturë	350.000,00
21	Ministria e shëndetësisë	Komuna Zveçan	Rekonstruimi i shtëpisë së shëndetit në Zveçan	Zveçan	Infrastrukturë	60.000,00

22	Ministria e shëndetësisë	Komuna Zveçan	Furnizimi me pajisje medicinale për nevojat e shtëpisë së shëndetit në Zveçan	Zveçan	Blerje e pajisjeve	60.000,00
23	Ministria e shëndetësisë	Komuna Leposaviq	Instalimi i ngrohjes në ambulancën në Soçanicë	Leposaviq	Infrastrukturë	9.995,00
24	Ministria e shëndetësisë	Komuna Leposaviq	Rekonstruimi i ndërtesës së vjetër të shtëpisë së shëndetit në Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	190.000,00
25	Ministria e shëndetësisë	Komuna Zubin Potok	Furnizimi me mobile dhe pajisje pune në shtëpinë e shëndetit në Zubin Potok	Zubin Potok	Blerje e pajisjeve	80.000,00
26	Ministria e shëndetësisë	Komuna Mitrovica Veriore	Furnizimi me pajisje për nevoja të institucioneve shëndetësore	Mitrovicë Veriore	Blerje e pajisjeve	600.000,00
27	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Zveçan	Ndërtimi i parkut të lojrave në qendër të Zveçanit	Zveçan	Infrastrukturë	30.000,00
28	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Leposaviq	Furnizimi me mjete pune i puntorisë për punimin e veshjeve kombtare KUD "Kopaonik"	Leposaviq	Blerje e pajisjeve	30.000,00
29	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i bazenit të qytetit në Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	850.000,00
30	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i shtegut të atletikës	Zubin Potok	Infrastrukturë	50.000,00
31	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i shtegut për rafting në lumin Ibër	Zubin Potok	Infrastrukturë	30.000,00
32	Ministria për kulturë, rini dhe sport	Komuna Mitrovica Veriore	Blerja e pajisjeve sportive për salla në shkolla	Mitrovicë Veriore	Blerje e pajisjeve	30.000,00
33	Ministria për kulturë, rini dhe sport		Blerja e semaforëve elektronik për salla sportive		Blerje e pajisjeve	100.000,00
34	Ministria për kulturë, rini dhe sport		Blerja e pajisjeve të gjimnastikës për salla sporti në shkolla		Blerje e pajisjeve	150.000,00
35	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Zubin Potok	Ndërtimi i stacionit hulumtues për institucionet shkollore dhe hulumtuese	Zubin Potok	Infrastrukturë	80.000,00
36	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Zubin Potok	Rikonstruimi i kulmit të shkollës Petar Koçiq, pas dëmit të shkaktuar nga era	Zubin Potok	Infrastrukturë	70.000,00
37	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Rekonstruimi i shkollave fillore në rajonin e komunës Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	200.000,00
38	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i fasadës së shkollës së Mesme Nikola Tesla	Leposaviq	Infrastrukturë	64.000,00
39	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Rekonstruimi i fushës së sportit në oborrin e shkollës fillore dhe të mesme teknike në Leposaviq.	Leposaviq	Infrastrukturë	18.122,00
40	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Pajisje për shkollën "Kadri Bistrica "	Leposaviq	Infrastrukturë	9.995,00
41	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i parkut dhe ndriçimit në plato para shkollës fillore në Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	9.883,00
42	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i dyerve dhe dritareve në shkollën fillore në Leposaviq.	Leposaviq	Infrastrukturë	90.000,00
43	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Ndërtimi i këndit të lodrave në kopshtin e fëmijëve "Nasha Rados" në Leposaviq	Leposaviq	Infrastrukturë	50.000,00

44	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë	Komuna Leposaviq	Furnizimi me pajisje i shkollës në Leshak	Leposaviq	Blerje e pajisjeve	36.000,00
